



DITARI MUJOR

QERSHOR 2025



Shpallen 181 projekte fituese të Programit Kombëtar të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit

U shpallën projektet fituese të Programit Kombëtar të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit për vitin 2025, me 181 projekte të financuara, me një rritje prej 40% krahasuar me një vit më parë. Fondi në dispozicion për kërkimin shkencor është 387,040,000 lekë dhe ai i infrastrukturës 350 milionë lekë, që rezultojnë të jetë 15% më i lartë se një vit më parë. Gjithash-tu u shpallën 55 projekte fituese të thirrjes së parë të programit READ, ku bashkë me Fondacionin Shqiptar-Amerikan për Zhvillim, u hodhën ura të reja bashkëpunimi mes studi-uesve vendës dhe diasporës sonë akademike.



Viti i ri shkollor me objekte të reja, vijon puna për rikonstruksionin e institucioneve arsimore

Viti i ri shkollor do të nisë me të tjera shkolla të reja. Ministria e Arsimit dhe Sportit inspektoi punimet për ndërtimin e shkollës "Met Hasa", që do t'u shërbejë mbi 250 nxënësve e mësuesve. Ndërkohë, janë gati të hapin dyert shkolla 9-vjeçare "Ali Metra" në Koms, falë investimit të Ministrisë së Arsimit dhe Bashkisë së Matit; gjimnazi i ri "Sulejman Elezi" në Laknas, shkolla 9-vjeçare "Kushtrimi i Lirisë" në Durrës, falë programit EU4Schools, të financuar nga BE-ja dhe zbatuar nga UNDP-ja; gjimnazi "Jani Nushi" si investim i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Bashkisë së Lushnjës etj.

Miratohet Projektigji për Sportin, më shumë mundësi për sportistët me aftësi ndryshe

Kuvendi i Shqipërisë miratoi projektligjin për ndryshimet në Ligjin për Sportin, që e bënë atë më gjithëpërfshirës dhe u jep mundësi të ushtrojnë talentin e tyre edhe individëve me aftësi ndryshe. Përfshirja në ligj e strukturave si Komiteti Paralimpik Kombëtar Shqiptar dhe Olimpiku Special Shqiptar dhe financimit të tyre nga buxheti i shtetit është edhe një angazhim karshi përmeshjes së kërkesave të Bashkimit Europian. Për herë të parë ligji njeh dhe mbështet rolin e fondacioneve sportive me qëllime publike, të cilat mund të themelohen nga institucione publike dhe të financohen nga buxheti i shtetit.



Shkolla verore, për herë të parë pilotimi në 10 shkolla në Tiranë, Durrës dhe Kamëz



Për herë të parë është pilotuar modeli i ri të Shkollave Verore. Programi i Shkollave Verore nisi në 16 qershor në 10 shkolla, 8 në Tiranë, 1 në Kamëz dhe 1 në Durrës, me një program të studiuar me ekspertizën më të mirë, duke përfshirë këtu dhe ekspertizën e UNICEF dhe në bashkëpunim me World Vision. Rreth 1000 nxënës të klasave I-V u përfshinë për herë të parë në një program dy javor në Shkollën Verore. Të gjitha hapësirat e shkollave: klasa, laboratorë, terrene sportive, kopshte dhe hapësira arti u vunë në dispozicion të këtij programi, për të cilin u angazhuan 150 mësues, punonjës socialë dhe oficerë sigurie. Stafit të mësuesve iu bashkuan edhe 100 të rinj nga 10 gjimnaze të vendit, që punuan në mënyrë vullnetare për mbarëvajtjen e Shkollës Verore.

PËRMBYLLET MATURA SHTETËRORE 2025, 27 MIJË NXËNËS JAPIN PROVIMET

Rreth 27 mijë maturantë në të gjithë vendin, në shkolla publike dhe private, dhanë provimet e Maturës Shtetërore 2025. Të rinjtë, të cilët tashmë nisin një etapë të re në jetën e tyre, drejt institucioneve të arsimit të lartë apo drejt tregut të punës, testuan njohuritë e tyre në lëndët matematikë, gjuhë-letërsi, gjuhë e huaj dhe lëndë me zgjedhje. Procesi u zhvillua në mënyrë korrekte dhe të qetë në të gjitha qendrat e provimeve, nën menaxhimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore, rrjetit të administratorëve të provimeve dhe stafeve pedagogjike.



PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL, TRAJNOHEN 10 MIJË MËSUES NË FAZËN I

U përmbyll me sukses faza e parë e Programit Kombëtar të Zhvillimit Profesional të Mësuesve 2025, ku mbi 10,000 mësues janë trajnuar në të gjithë vendin, për të rritur aftësitë në fusha kyçe si gjuha shqipe, matematika, shkencat natyrore dhe teknologjia. Ky program ka një rëndësi të posaçme për zhvillimin profesional të mësuesve mbi bazën e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies, të cilat, gjithnjë e më shumë, orientojnë drejt digjitalizimit, teknologjisë dhe informacionit.